



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr. 11386 /2019
Data: 16.12.2019

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e -XI- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 27.11.2019 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Edon Curri (Drejtor për Administratë), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Medina Imishti (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim), Përfaqësuesit e OSB-së. Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnje anëtarë i Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Zëvendësimi i anëtarit të Komitetit për Politik e Financa.
3. Miratimi i propozim ndryshimit të rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Hanit të Elezit.
4. Miratimi i propozim rregullores për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal miqësorë për fëmijët.
5. Miratimi i propozim vendimit për caktimin e normave tatimore të tatimit në pronën e paluajtshme të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020.
6. Miratimi i propozim vendimit për transfer në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje për vitin 2019.
7. Miratimi i propozim vendimit për planin komunal për riintegrin të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar për vitet 2019-2022
8. Miratimi i kërkesës së z. Avdi Dernjani për ndërrim destinim të pronës.
9. Miratimi i kërkesës së z. Ilir Bushi për ndërrim destinim të pronës.
10. Shqyrtimi i informatës mbi ndarjen e subvencioneve në bujqësi.
11. Shqyrtimi i informatës lidhur me progresin për zbatimin e rekomandimeve të auditimit për vitin 2018.
12. Shqyrtimi i informatës mbi gjendjen në shëndetësi gjatë muajve Janar-Tetor 2019.
13. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- kjo mbledhje është e para pa shefin e grupit parlamentar të LDK-së z. Nuriman Kuka dhe në shenjë nderi edhe me viktimat në Shqipëri që ndodhën nga tërmeti ju ftot për një minutë heshtje, "Lavdi". Lidhur me pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Zëvendësimi i anëtarit të Komitetit për Politik e Financa.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Samire Curri thekson:- në emër të grupit parlamentar të LDK-së propozoj z.Sabedin Hasallari që të jetë anëtarë në Komitetin për Politik e Financa.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA QË z.SABEDIN HASALLARI TË JETË ANËTARË I KOMITETIT PËR POLITIK E FINANCA NGA RADHËT E LDK-së

3. Miratimi i propozim ndryshimit të rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Rufki Suma thekson:- rregulloren të cilën e kemi pasur ka qenë e mirë për shkak se i ka përfshirë të gjitha fshatrat dhe lagjet e komunës së Hanit të Elezit. Pas ndryshimeve që ka pasur udhëzimi administrativ ka përcaktuar që komunat të cilat i kanë 10000 banorë t'i kenë katër këshilla të fshatrave. Kemi bërë disa propozime që kemi menduar që janë më të arsyeshme. Rregullorja është shqyrtuar në Kuvendin e Komunës, në debat publik dhe është përcjell për miratim në Kuvendin e Komunës. Nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni

Mefail Suma thekson:- nenit tre përcakton që në bazë të numrit të banorëve parashihen katër këshilla por te shtojca e dytë është paraparë Lagja e Ujit të Thartë me një pjesëmarrës , Hani i Elezit është përcaktuar barabartë me Seçishtën dhe potencohet se numri i përgjithshëm i këshillave të fshatrave është prej pesëve deri nëntë anëtarë. Përmendën katër këshilla por nga sa do të jetë numri i këshillave por si u përcaktua numri i pjesëmarrësve sepse Dimcës dhe Dermjakit i është lënë nga një përfaqësues kurse të gjithë e dinë që fshati Dimcë numerikisht është më i madh prej numrit të banorëve. Po ashtu edhe Lagja e Ujit të Thartë ka shumë banorë dhe është lënë me një përfaqësues. Unë mendoj që nuk është bërë përpjessëtimi mirë për këtë çështje.

Akif Shkreta thekson:- a keni biseduar me banorët e Lagjes së Re sepse ka informacione se ata nuk duan me iu bashkangjitur Seçishtës. Ndarjes të cilën e pashë mund të them që është e mirë për shkak se i ke katër mundësi dhe nuk mund të bësh diçka më ndryshe. Unë mendoj se ideja më e rëndësishme është që këta këshilla me funksionuar sepse nuk ka rëndësi se kush me këndë bashkohet sepse nëse funksionojnë kjo është e mirë.

Mehmet Ballazhi thekson:- shqetësimet e mia që në fillim ishin te ndarja e zonave që do të përfshihen nëpër këshilla dhe ndoshta do të ketë problem sepse nëse nuk ka shkuar në bazë të zonave kadastrale është marr një vijë se cila pjesë do të bashkëngjitet dhe shqetësimin e kam shprehur te Lagja e Re sepse nuk dihet një vijë fiksë se cila pjesë i bashkëngjitet Seçishtës. Te emri i fshatit Dermjak është mirë që zyrtarisht siç është me shënuar. Te fshati Neqafc dhe Vërtomicë është lënë me zero zero përfaqësues ndërsa këtu janë përcaktuar dy dhe duhet të dihet se kush do t'i përfaqëson këto fshatra. Sa i përket numrit më shumë është bërë i dëshirueshëm sepse në Lagje të Re janë lënë dy përfaqësues por Lagja e Re për nga numri i banorëve është më e madhe se sa fshati Krivenik dhe është mirë me rregulluar.

Hanumshahe Dibrani thekson:- kérkoj sqarim për nenin 4.4 Komisioni i emëruar-themeluar nga Kuvendi i Komunës, nëpërmjet zyrës për informim, informon qytetarët 15-7 ditë para datës së mbajtjes së tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e këshillave lokale.

Florim Shkreta thekson:- un mendoj që qytetarët nuk janë të informuar mirë se kush me cilën pjesë ka me u bashkangjitur sepse në debat publik vetëm zyrtarë komuna ka pasur, mirépo është e nevojshme që ende të njoftohen banorët. Udhëzimi i më hershëm nuk e ka përcaktuar që me u paguar kryetarët e këshillave të fshatrave por kryetari në mandatin e më hershëm ka potencuar që është duke biseduar për me i paguar kryetarët e këshillave të fshatrave. Në komunën e Gjilanit kryetarët e këshillave të fshatrave ishin paguar nga komuna. Pavarësisht se kush është kryetarë i këshillit të fshatit do të ishte mirë që të paguhen nga komuna.

Nora Xhoni thekson:- unë mendoj që me formimin e katër këshillave të fshatrave do të ecin punët më mirë dhe nuk është shumë e rëndësishme se me cilin fshat apo lagje kanë dëshirë të shkojnë por me rëndësi është me punuar dhe me pasur suksese.

Rufki Suma thekson:- udhëzimi administrativ e përcakton numrin e anëtarëve prej pesë deri në nëntë anëtarë por vendosin fshatrat dhe lagjet për përbërjen. Lagja e Re është zonë urbane dhe këshilli i Hanit të Elezit e përfshinë zonën urbane. Nenin 4.4 e përcaktonë afatin për informimë dhe kjok atë bëjë me komisionin që do ti organizonë zgjedhjet. Është diskutuar çështja e pagesës por nuk kemi pasur mundsi për shkak legjislacionit dhe më herët ia kemi kompenzuar me mbushje telefonike. Sa i përket debatit publik ftesa ka qenë por qytetarët shumë pak vijnë në debate. Sa i përketë Dermjakut me ligje kanë përcaktuar Dromjak. Fshati Neqafc dhe Vertomicë nuk kanë banorë dhe mbesin në kuadër të Paldenicës.

Isni Bushi thekson:- për Lagje të Re ndoshta do të ishte më mirë që Drejtoria e Administratës me biseduar që ata me iu bashkangjitur Seçishtës sepse do të na ndihmonte edhe për çështjen e shkollës për të cilën kemi formuar komision me u marr me këtë çështje.

Teuta Shkreta thekson:- a janë specifiku pikat se prej cilës pjesë quhet Lagja e Re?

Sabedin Hasallari thekson:- nëse mbetet që Lagja e Re me shkuar me fshatin Seçishtë vullneti i tyre nuk është dhe nxënësit nuk i dërgojnë në Seçishtë për me i ndjekur mësimet. E them këtë duke u bazuar në informacionet që i kam nga banorët e asaj lagje.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 13 për 1 kundër.

U MIRATUA PROPOZIM NDRYSHIMI I RREGULLORES PËR TRANSPARENCE

4. Miratimi i propozim rregullores për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal miqësorë për fëmijët.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Medina Imishti thekson:- përvëç materialit të cilin e kemi përcjellur diçka të veçantë nuk kam.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim rregulloren; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RREGULLORJA PËR REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE PËRMES SISTEMIT QEVERISËS KOMUNAL MIQËSORË PËR FËMIJË

5. Miratimi i propozim vendimit për caktimin e normave tatimore të tatimit në pronën e paluajtshme të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- deri në vitin e kaluar kemi miratuar rregulloren e tatimit në pronë , ndërsa decidivisht potencohet që kuvendi duhet t'i caktojë normat tatimore për të gjitha kategoritë e pronave. Normat janë njëjtë sikur viteve të kaluara dhe niveli më i ulët është 0.15 , me përjashtim te njësitet komerciale te objektet industriale është 0.20. Në imell ua kemi dërguar Ligjin e Tatimit në Pronë dhe raportin e përgjithshëm nga ministria për të gjitha parcelat, nivelin e vlerave dhe të zonave. Përveç materialit të dërguar diçka të veçantë nuk kam.

Florim Shkreta thekson:- a ka komuna qasje në përcaktimin e zonave apo direkt Prishtina vendosë?

Kryesuesi thekson:- besoj që marrin këshilla edhe prej zyrtarëve profesional të cilët janë në kadastër.

Florim Shkreta thekson:- sipas informacioneve që kam komuna për këtë çështje nuk ka pasur bashkëpunim ashtu siç kanë dashur përfaqësuesit nga Prishtina kanë vendos në Han të Elezit.

Mehmet Ballazhi thekson:- shqetësimi i më hershëm ka qenë problem me çështje të pronësisë dhe përsëri propozoj që ne si kuvend ta gjejmë një mënyrë që të ju lehtësohet qytetarëve bartja e pronësisë për shkak se pronësia nuk përcaktohet siç është në realitet dhe do të paraqet problem gjatë zbatueshmërisë së kësaj takse për shkak se nuk dihet adresa se kujt i shkon taksa për me kryer tatimin në pronë. Unë mendoj që komuna duhet ta ngritë një grup punues apo këshillëdhënës që tu ndihmon qytetarëve për çështjen e pronësisë. Komuna duhet t'i zhvillon procedurat e prokurimit në mënyrë që të kontrakton një kompani të licencuar për me i ndarë parcelat kadastrale sepse do të ishte lehtësim i madh për qytetarët.

Sabedin Hasallari thekson:- norma tatimore a është përcaktuar prej nivelit qendrorë dhe a është e njëjtë për të gjitha komunat e Kosovës apo ndryshon?

Shabi Rexhallari thekson:- norma tatimore është e përcaktuar me Ligj. Problemet me prona ekzistojnë dhe në këtë vit kemi pasur 20 ankesa nga tatimpaguesit dhe i kemi përcjellë në Ministri të Financave.

Kryesuesi thekson:- në KPF z. Mehmet Ballazhi ka propozuar me gjet mënyrë që me ndihmuar qytetarin për shkak se nëse fillohet me u implementuar në vitin 2021 zbatimi do të jetë i vështirë për shkak se pronat nuk janë të definuara. Propozimin duhet ta analizoni dhe duhet të shikohen mundësitë për me i ndihmuar qytetarët.

Mefail Suma thekson:- sipas informacioneve që kam fshati Gorancë, fshati Seçishtë, fshati Paldenicë , është bërë rindërtimi i kadastrit për çështje të pronave. Për me bërë bartjen e pronësisë dhe ndarja e parcelave kadastrale bëhet një kosto e lartë për qytetarin dhe është mirë me i ndihmuar qytetarët për këtë çështje.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE TË TATIMIT NË PRONËN E PALUAJTSME TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2020

6. Miratimi i propozim vendimit për transfer në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje për vitin 2019.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- nga Departamenti i Thesarit na është dërguar një shkresë për shkak se komuna ka mungesë në kategorinë e pagave dhe mëditjeve dhe kanë kërkuar që të merret vendim në Kuvendin e Komunës që të bëhet harmonizimi. Viteve tjera qeveria e ka kryer pa vendim dhe meqë qeveria nuk është funksionale kanë kërkuar që kuvendi me marr vendim. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- në cilin kriter jeni bazuar që keni bërë shpërndarjen në kode të mjeteve financiare.

Shabi Rexhallari thekson:- është nxjerr lista sipas sistemit që e kemi dhe në bazë të alokimit të një të dyshëdhjetës del që për janar tector e dimë se sa kemi minus dhe sa është plusi në të gjitha drejtoritë. Për me mbuluar tectorin ne kemi marr shpenzimin se sa ka me qenë nëntori në mënyrë që mos me marr vendim përsëri në muajin tjetër.

Akif Shkreta thekson:- si do të bëhet implementimi i pagave jubilare?

Shabi Rexhallari thekson:- Drejtoria e Arsimit e ka bërë një listë për ata të cilët i kanë bërë dhjetë, njëzet apo tridhjetë vite punë dhe shuma është mbi 3000 € në këtë vit do të kryhen.

Teuta Shkreta thekson:- punëtorët shëndetësorë pse nuk e marrin pagën jubilare? Pse nuk ka mjet financiare në Drejtorin e shëndetësisë për me u bërë pagesa e pagave jubilare? A përcillet për vitin tjetër apo si do të veprohet?

Shabi Rexhallari thekson:- buxhetin të cilin e kemi miratuar për vitin 2020 nuk janë planifikuar mjetet për këtë çështje dhe po që se kemi mundësi do t'i procedojmë.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR TRANSFER NË KATEGORINË PAGA DHE MËDITJE PËR VITIN 2019

7. Miratimi i propozim vendimit për planin komunal për riintegrin të qëndrueshmë të personave të riatdhesuar për vitet 2019-2022.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Edon Curri thekson:- përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Florim Shkreta thekson:- kërkoi sqarim rrëth këtij plani se për cilët persona bëhet fjalë a për ata të cilët kanë shkuar nga Hungaria apo edhe për personat që ishin në Siri të cilët mendoj se janë më të dëmtuarit në vend.

Edon Curri thekson:- është për personat të cilët kanë dalur jashtë vendit dhe janë kthyer por i përfshin edhe personat të cilët kanë shkuar në Siri.

Sabedin Hasallari thekson:- sa persona janë të komunës sonë të cilët janë riatdhesuar dhe a kanë përfituar prej shtetit këto persona?

Edon Curri thekson:- numrin nuk e kam të saktë për momentin por ua dërgoj me shkrim.

Mehmet Ballazhi thekson:- unë mendoj që nuk është vetëm problemi i personave të cilët kanë shkuar në luftë në Siri apo diku tjetër por është plan për riatdhesim i të gjithë atyre që kanë shkuar për arsyet e ndryshme dhe kthehen dhe bëhet riintegrimi ekonomik i atyre personave.

Rufki Suma thekson:- Ministria e Punëve të Brendshme e ka një listë dhe ka ndihmuar në projekte të ndryshme personat të cilët janë kthyer.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR PLANIN KOMUNAL PËR RIINTEGRIM TË QËNDRUESHËM TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR PËR VITET 2019-2022

8. Miratimi i kërkesës së z. Avdi Dernjani për ndërrim destinim të pronës.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:- përveç materialit që e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA KËRKESA E Z. AVDI DERNJANI PËR NDËRRIM DESTINIM TË PRONËS

9. Miratimi i kërkesës së z. Ilir Bushi për ndërrim destinim të pronës.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:- përveç materialit që e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA KËRKESA E Z. ILIR BUSHI PËR NDËRRIM DESTINIM TË PRONËS

10. Shqyrtimi i informatës mbi ndarjen e subvencioneve në bujqësi.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe në material i keni informacionet për subvencionet në bujqësi.

Mehmet Ballazhi thekson:- pse është bërë transferimi i mjeteve te OJQ - Labi për shkak se ata në vend që me ndihmuar qytetarin i bien që komuna po e mbështetë një OJQ? Sa ka participuar OJQ – Labi në këtë projekt?

Zaim Bela thekson:- transferi i mjeteve është bërë për shkak se Zyra e Prokurimit e komunës ka qenë e ngarkuar shumë dhe në konsulta me Drejtoren e Financave u dakordua që më mirë me ia transferuar mjetet financiare OJQ – Labi dhe ata me i zhvillu procedurat e tenderimit. OJQ – Labi ka subvencionuar në shumë prej 5000 € në këtë projekt.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

11. Shqyrtimi i informatës lidhur me progresin për zbatimin e rekomandimeve të auditimit për vitin 2018.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- kemi formuar një komision për këto rekomandime që i kemi dhe nga shtatë rekomandimet që i kemi një është zbatuar plotësisht, një nuk është zbatuar dhe pesë rekomandimet tjera janë në proces por ne duhet të presim deri në fund të vitit në mënyrë që të dimë se ku kemi arritur. Te opinioni i parë është me theksim të çështjes për shkak se nuk janë regjistruar disa pasuri dhe zyrtari i ka regjistruar më vonë mirëpo pa u shpenzuar buxheti nuk mund të themi që është kryer kjo. Te çështja e dytë e realizimit të buxhetit duhet të presim deri në fund të vitit për çështjen e shpenzimit të buxhetit. Çështja e tretë është niveli i ulët i inkasimit të të hyrave të taksave komunale që ka të bëjë me Drejtoren e Zhvillimit Ekonomik për taksat e bizneseve. Drejtoria ka filluar procedurën me vërejtje dhe disa kanë lidhur kontratë e disa jo. Çështja e katërt ka të bëjë me menaxhimin e dobët të pasurive komunale e cila ka të bëjë me komisionin që është formuar nga komuna, nga shkollat dhe shëndetësia dhe janë duke punuar komisionet. Rekomandimi i pestë ka të bëjë me mungesën e mekanizmave për inkasimin e të arketueshmeve ka të bëjë me taksën e bizneseve dhe të hyrat nga qiraja. Nga dita e djeshme kemi filluar me vërejtje për taksapaguesit të cilët kanë mbi 300 €. Çështja e gjashtë ka të bëjë me mungesën e themelimit të NJAB-së dhe në këtë vit është miratuar një rregulllore e re nga qeveria e cila parashev që organizatat të cilat kanë më pak se tre milionë euro buxhet funksionimin e njësisë së aduditimit mund ta kryejnë përmes Ministrisë së Financave me kërkesë. Rekomandimi i shtatë ka të bëjë me dobësi në kontrolllet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut kemi filluar me listën e rreziqeve të cilën e kemi përgatitur. Raportimin jetër sa i përket progresit do ta kemi në muajin prill.

Mehmet Ballazhi thekson:- disa veprime të cilat janë marr nuk shohë që do te këtë ndonjë rezultat të mirë por do të presim raportin e auditimit në muajin prill dhe t'i shohim se sa janë realizuar. Rekomandimi i pestë Mungesa e mekanizmave për inkasimin e të arketueshmeve është krijuar një lloj i stoqeve të borxheve të painkasuara. Listën të cilën e keni bërë realisht është dashur të jetë sepse nëse nuk e keni pasur deri tash është një lloj neglizhencë.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

12. Shqyrtimi i informatës mbi gjendjen në shëndetësi gjatë muajve Janar-Tetor 2019.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Medina Imishti thekson:- kemi investuar në investime kapitale duke pajisur ambulancën me një deflibilatorë dhe një autoambulancë dhe një pajisje e cila shërben për analiza të cilat nuk janë bërë. Gjatë periudhës Janar –Tetor janë bërë 22,213 shërbime në sektorin e mjekësisë familjare. Kurse në sektorin e emergjencës janë bërë 11,429 shërbime. Në KPF i kemi diskutuar shpenzimet e autoambulancave që te autoambulanca Reno ju është dukur që ka pasur shpenzime, mirëpo pas mbledhjes i kam kërkuar të gjitha fletëudhëtimet dhe faturat e derivateve dhe me numër të kilometrave përputhen dhe i bien që 13 litra i shpenzon një autoambulancë për 100 km. Nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- në tabelar po të shikon ka shumë mospërputhshmëri. Te vetuar e autoambulancës Pezho në korrik e ke 561 km dhe 152 litra të shpenzuara që do të thotë nuk ka mundësi me u përputhur numri i kilometrave me shpenzimet e derivateve por fundin e keni barazuar dyqyshë por brenda muajit është e palogjikshme. Për muajin gusht shënon që për 1,209 km dhe 125 litra. Për muajin shtator 684 km kurse 58 litra që do të thotë nuk ka përputhshmëri. Është mirë të shikohen këto shpenzime sepse nuk përputhen. Rasti sëmundjeve me CA në cilën periudhë janë evidentuar? Vizitat sistematike në shkolla sa herë janë mbajtur në për shkolla? Nëse keni identifikuar mangësi gjatë realizimit çka keni vepruar për me i evitar vështirësitë? Kërkoj sqarim për numrin e punëtorëve me kontrata të veçanta në periudha më të gjata.

Medina Imishti thekson:- kjo formë e raportit është fakt që në shikim të parë kështu doket sepse ka qenë edhe më herët dhe kam vazhduar me këtë formë dhe pos mbledhjes së KPF – së i kam analizuar dhe vërehen që janë në rregull. Për vizitat sistematike në shkolla edhe për vitin 2018 dhe për vitin 2019 kemi planifikuar që dy herë gjatë viti me pasur vizita sistematike nëpër shkolla. Në vitin 2018 nuk është mbajtur asnjë vizitë, kurse për vitin 2019 është mbajtur një vizitë. Sa i përket vështirësive e kemi potencuar mungesën e stafit të cilën e kemi dhe rritja e stafit është bërë përmes shoqatave por kemi problem edhe me hapësirën e QKMF-së. Sektori i stomatologjisë po mendojmë me funksionalizuar nëse rritet stafi.

Akif Shkreta thekson:- për herëve të tjera duhet të dallohet mënyra e kilometrave apo të shënohen me një rubrikë të veçantë të potencoohen kilometrat dhe çështja të sqarohet në mënyrë që mos të ketë konfuzitet.

Samire Curri thekson:- falënderoj drejtoreshën për punën të cilën po e kryen por edhe stafin e QKMF-së duke filluar nga drejtori, kryeinfirmierja, mjekët dhe infermierët për punën e palodhshme të cilën po e kryejnë në shërbim të qytetarëve të komunës këtë po e shohë për çdo ditë për shkak se jam duke e kryer praktikën vullnetare. Si sektorë i shëndetësisë ju përgëzoj për punën të cilën po e bëni dhe besoj që kjo rutinë e punës do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Nora Xhoni thekson:- sa i përket vështirësive të punës më e rëndësishme do të ishte shërbimi i shëndetësisë me hyrë në funksion, ndërsa sa i përket hapësirës mendoj që është e mjaftueshme

Sabedin Hasallari thekson:- gjatë kësaj periudhe a është bërë sistemi elektronik i pacientëve. Gjatë kontrolleve teknike që i keni bërë nëpër shkolla a ke vërejtur se sa është niveli i pastërtisë te nxënësit? Pse nuk funksionon sektori i stomatologjisë? Sa keni bërë në informimin e qytetarëve për sëmundjen e kancerit të gjirit dhe ku qëndron problemi i mos sjelljes së aparatit mamografik?

Florim Shkreta thekson:- ka ankesa nga qytetarët të cilët kur i kanë shkuar me i bërë analizat në laboratorë ka munguar materiali i thjeshtë.

Medina Imishti thekson:- ne kemi mbajtur takim me këshillin drejtues të QKMF-së dhe kemi marr vendim që stomatologja të zëvendësohet me dhomën e nënave të fëmijëve që do të thotë që objekti ka nevojë edhe për dhoma të reja. Sa i përket sistemit elektronik besoj që kemi me ia dalë si QKMF dhe si Kosovë. Infermierët kanë mbajtur trajnime për këtë çështje. Sa i përket aparatit mamografik kemi bërë kërkesë por në komuna të vogla zakonisht nuk i sjellin.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

13. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Samire Curri thekson:- Drejtori i Shërbimeve Publike po e bënë një punë të palodhshme dhe sukseset e tij s”kanë të ndaluar në asfaltimin dhe ndriçimin e rrugëve të Hanit të Elezit. Në punimet e fundit të cilat janë kryer kërkesë kam që të vendosen policët e shtrirë në rrugën “Hasan Prishtina-Nehat Curri” sepse po i vozisin me shpejtësi të lartë veturat e që ndikon në sigurinë e qytetarëve.

Florim Shkreta thekson:- e përshëndes parafolësen dhe nuk e di a e ka parë shtyllën elektrike në mes trotuarit dhe do të ishte mirë që ta kërkon që ajo shtyllë me u hequr nga trotuari. Sa i përket përgjigjeve që më janë dërguar nuk më është dërguar aktgjykim për parcelën që e kam kërkuar sepse në bazë të numrit nuk mundem me zbuluar

asgjë. Kërkoj aktgjykimin e kësaj parcele të cilën e kam kërkuar dhe nëse është konfidenciale është mirë që të më shpjegojet.

Kryesuesi thekson:- përgjigjja që është dërguar unë nuk ta kam dhënë por është dhënë nga ekzekutivi i komunës dhe nëse pyetem si Qamush Brava këtë informacion nuk ta jap sepse kjo çështje është e viti 2004 dhe nëse ke diçka për këtë çështje mund të drejtoheni në gjykatë e jo në komunë për shkak se komuna për një çështje të njëzet viteve nuk ka kompetencë ty si këshilltarë me të svaruar por këta për shkak të sinqeritetit tu kanë përgjigjur në pyetje. Kjo është çështje e vitit 2004 që Hani i Elezit komunë nuk ka qenë dhe nëse dëshiron me marr informacione të plota mund t'i drejtoheni gjykatës. Përgjigjen për këtë çështje e ka dhënë ekzekutivi i komunës. Të drejtë për qasje në dokumentet zyrtare ke dhe mundesh në bazë të numrit me kërkuar në gjykatë dhe vëren që ka diçka mundesh me ngritur këtë çështje por ju duhet ta dini se çështjet pronësore asnjëherë nuk vjetërsohen. Rastin e kam pasur çështje pronësore dhe e kam ngritur pas 40 viteve. Ju e dini se këtu është bërë një dëm dhe ka konspiracione dhe rasti është i hapur por nuk dua të hyjë në këto çështje. Një ari pronë më është paguar 12 000 € por në Han të Elezit në periferi 35 000 € është paguar një ari pronë që do të thotë se është dashur me i marr 60 000 € por më janë paguar vetëm 18 000 € që do të thotë se e kam falur pronën. Në kohë të fushatës i kuptoj këto çështje por tash nuk jemi në fushatë dhe pa të drejtë je duke ma lakuar emrin e prindit tim që tetë muaj që mendoj që nuk është e drejtë.

Florim Shkreta thekson:- më vjen keç prej asaj se çka ka ndodhur por nuk po e komplettoni përgjigjen për pyetjen të cilën e kam parashtruar dhe ju mund të potenconi se kjo çështje është konfidenciale dhe nuk të lejohet ta merrni aktgjykimin atëherë jemi në rregull, mirëpo si tu është ndarë ajo pronë pikërisht në atë vend dhe nuk ka asgjë të keçe nuk ka nëse ma dërgoni aktgjykimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- unë të kuptoj ty si kryesues por edhe Florimin për mënyrë se si dëshiron me nxjerrë informacionin por nuk është mirë ta lëshoni veten në këtë mënyrë dhe si kryesues i kuvendit është mirë që t'ia tregoni rrugën për çështje të informacionit. Në dy lokacione ku janë bërë analizat e ujit janë dal bakterorë. A është bërë ndonjë angazhim që me sensibilizuar opinionin për çështjen e atij uji për shkak se shumica e qytetarëve mbushin ujë në fshatin Dimcë. Kohët e fundit është investuar një shumë e mjeteve financiare por megjithatë uji është i papërdorshëm dhe shihet që është një investim i gabuar dhe i keçmenaxhuar. Është mirë të iniciohen procedurat për çështjen e trafos elektrike në fshatin Pustenik për shkak se përsëri po shfaqen të njëjtat probleme të tensionit të rrymës.

Florim Shkreta thekson:- kërkoj aktgjykim se si është fituar prona që është në emër të z.Sami Brava. Drejtoria për Shërbime Publike ka dhënë disa përgjigje por kërkoj sqarim sa i përket përgjigjeve të cilat më janë dhënë për kompaninë për të cilën bëhet fjalë a lirohet apo nuk lirohet nga taksa. Kërkoj sqarim për konkursin te shkolla fillore "Ilaz Thaçi" për lëndën e historisë për shkak se është shpallur rezultati i pikëve dhe pas një kohe ka ndryshuar rezultati.

Menduh Vlashi thekson:- sa i përket shpalljes së rezultatit është ashtu siç potenconi por komisioni gjatë mbledhjes së pikëve ka bërë një gabim teknik dhe pastaj e ka bërë ndryshimin.

Refet Kalisi thekson:- përvèç përgjigjeve të cilat iu kam përcjell diçka më shumë nuk kam çka të shtoj.

Florim Shkreta thekson:- përsëri e kërkoj përgjigjen me shkrim prej Drejtorisë për Shërbime Publike sepse nuk më është dhënë përgjigjja.

Hanumshahe Dibrani thekson:- ura e cila është mbi hekurudhë duhet me u rregulluar ndriçimi për shkak se për fëmijët të cilët lëshohen nga shkolla është problem sepse është shumë errësirë. Te Ura e Seçishtës një shtyllë elektrike është lakuar dhe është mirë me marr masa për shkak se paraqet rrezikshmëri për qytetarët.

Refet Kalisi thekson:- dritat i kemi vendosë por i kanë dëmtuar por do të vendosim përsëri. Sa i përket shtyllës elektrike kërkesën e kemi dërguar në KEDS.

Teuta Shkreta thekson:- ankesë kam nga pronarët të cilët i kanë lokalet te kufiri për shkak se udhëtarët të cilët ndalen për me blerë në shitore dënohen nga policia.

Sabedin Hasallari thekson:- pse nuk janë marr mostrat për me i bërë analizat për ujin e Glloboçicës? A është ndërmarr diçka për vendosjen e mbrojtëseve për te shtëpia e z.Nexhemdin Fida sepse është problem i madh për shkak se rruga është bërë e qarkullueshme në atë pjesë?

Refet Kalisi thekson:- sa i përket mbrojtëseve fillimi sh duhet të bëhet muri për shkak se mbrojtëset nuk kanë vend se ku me i vendosur. Duhet të vendoset mur i betonit por në këtë vit nuk mundemi por do t'i shikojmë mundësitë në vitin e ardhshëm. Analizat e ujit të Glloboçicës i bënë kompania "Bifurkacioni" për çdo muaj.

Medina Imishti thekson:- analizat e ujit janë bërë me qëllim në krojet publike dhe kemi menduar që edhe një herë me i përsëritur dhe pastaj me i publikuar.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendit të komunës. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 14:16

Procesmbajtësi

Ayni Bushi

